



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:215290
Datë: 01.03.2024
Numri i dokumentit: 05398024

C.nr.913/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.S, A.M, dhe N.A, të gjithë nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson Av. Sh.Z, nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 1,940,00 euro, jashtë seancës, më datën 01.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.S, A.M, dhe N.A, të gjithë nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëst N.S, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 322 ditë pune të ja paguajë shumën prej 644,00 euro, duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 06.10.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.M, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 324 ditë pune të ja paguajë shumën prej 648,00 euro, duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 06.10.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.A, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 324 ditë pune të ja paguajë shumën prej 648,00 euro, duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 06.10.2023 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve N.S, A.M, dhe N.A, t'i paguajë

shumën prej 239,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit N.S, A.M, dhe N.A, më datën 06.10.2023, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë.

Paditësit janë mësimdhënës pran SH.M.F.U. “Dëshmorët e Lirisë”, në Pataqan të Poshtëm, Komuna e Rahovecit, dhe janë në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 dhe atë për 322, 324 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 07.02.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 06.10.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, për periudhën kohore nga 21.01.2021 e deri më 21.11.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017. Paditësit, referuar Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017, me kërkesëpadi kanë kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, ngase KKAK e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri më 21.01.2021. E paditura konsideron se gjykata duhet të merr për bazë vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e KKAK-së të vitit 2017, afati i zbatimit i së cilës është përcaktuar sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të datës 27.02.2023, Kapitulli II pika IV, nga hyrja në fuqi, në mënyrë që padia e paditësve të ketë themelësinë e saj sa i përket bazës ligjore. Nga kjo rezulton qartë se nuk mund të kërkohet kompensim për periudhën përtej vlefshmërisë së kontratës. ashtu që kërkesëpadija e paditësve qartazi është përfshirë në parashkrim, ngase kanë kaluar më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi e kontratës në të cilën paditësit janë thirrur, e tërë kjo konform nenit 87 të Ligjit të Punës i Kosovës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kontrata e Punës nr. prot. 651, të dt. 29.06.2021, Vërtetimi nr. 1170/1, të datës 09.06.2023 për N.A, Kontrata e Punës nr. prot. 1/787, të dt. 11.05.2021, Vërtetimi nr. 1177/1, të datës 09.06.2023 për A.M, Kontrata e Punës nr. prot. 757, të dt. 01.09.2015, Vërtetimi nr. 1172/1, të datës 09.06.2023 për N.A.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë pasur të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. të protokollit 651, të dt. 29.06.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit N.S, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” në fshatin Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1170/1, të datës 09.06.2023, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” në fshatin Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.S në periudhën kohore 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 322 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. të protokollit 1/787 të datës 11.05.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” në fshatin Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1177/1 i datës 09.06.2023, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” në fshatin Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.M në periudhën kohore 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 324 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. të protokollit 757 të datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit N.A, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” në fshatin Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1172/1 i datës 09.06.2023, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” në fshatin Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.A në periudhën kohore 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 324 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësin në periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar në 322, 324, ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore*”. Në rast se shumëzohen 322 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 644.00 euro. Për 324 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 648.00 euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (06.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësve t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 239.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 31.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.913/2023, më datën 01.03.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.